

300/11
647

STRATEGJIA AFATMESME E SISTEMIT TË BURGJEVE
(SAB 2014 - 2017)

HYRJE

Ky dokument prezanton Strategjinë Afatmesme të Sistemit të Burgjeve, që synon reformën e mëtejshme në sistemin penitenciar në Republikën e Shqipërisë, rritjen më tej të kontributit të këtij sektori në zhvillimin e shoqërisë shqiptare, rritjen e besimit të publikut dhe përmirësimemëtejshëm të respektimit të të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve, me qëllim përshpejtimin e integritetit evropian.

Kjo strategji bazohet në politikat ekzistuese të Qeverisë Shqiptare të orientuara drejt perspektivës për aderim në Bashkimin Evropian, të prezantuara nëpërmjet dokumenteve kyçe, si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit, si dhe Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve kyçe të Komisionit Evropian.

Në themel të analizës së kësaj Strategjie është hartimi i një dokument strategjik, që synon planifikimin e politikave mbështetur në prioritetë të zbatueshme dhe tëprekshme dhe kosto efektive, sipas mundësive ekzistuese financiare, për ofrimin me cilësi dhe shpejtësi të shërbimeve në sistemin e burgjeve.

Forcimi i sundimit të ligjit dhe respektimi i parimeve demokratike e të drejtave themelore, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë prioritetet më të rëndësishme të adresuara nga Bashkimi Evropian, duke theksuar rëndësinë e tyre në zhvillimin e demokracisë shqiptare. Legjislacioni i BE-së mbi të drejtat themelore bazohet në Traktatet e Bashkimit Evropian, të cilët promovojnë respektin për të drejtat e njeriut, mosdiskriminimin dhe parandalimin e torturës dhe keqtrajttimeve.

Bashkëpunimi për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ka për qëllim zbatimin dhe garantimin e kriterëve të Kopenhagen-it për të drejtat e njeriut dhe detyrimet që rrjedhin nga përafrimi, si dhe krijimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e legjislacionit të BE-së mbi të drejtat themelore. Reforma në sistemin e burgjeve mbështetet në një set dokumentesh strategjikë, të cilat dëshmojnë angazhimin politik dhe institucional për forcimin e shtetit të së drejtës dhe konsolidimin e të drejtave themelore. Dokumente strategjike si Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), Strategjia Ndër-sektoriale e Drejtësisë (SND), Strategjia e Luftës kundër Korrupsionit, si dhe Plani i Veprimit për adresimin e 12 prioritetëve kyçe të Komisionit

Evropian, përmbajnë si objektiv strategjikgarantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës nëpërmjet sigurimit të transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, duke përfshirë edhe sistemin e burgjeve. Për më tepër, Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit thekson gjithashtu nevojën për të mbrojtur të drejtat e njeriut, duke siguruar masa/aktivitete afat-mesme dhe afat-gjatë, ndërsa Dokumenti Shumëvjeçar Indikativ i Planifikimit (MIPD), përcakton nevojën për "Përmirësimin e infrastrukturës në sektorin gjyqësor, sistemin e burgjeve dhe të paraburgimit".

Strategjia merr në analizë çështjet e identifikuar nga sistemi i burgjeve, si dhe ato të ngritura përgjatë procesit konsultativ me dokumente, opinione dhe raporte për sistemin e burgjeve. Objektivi i hartuesve të këtij dokumenti është që prioritetet e evidentuara të kontribuojnë si një mjet efektiv në ndihmë të hartuesve të politikave, për promovimin e bashkëpunimit me partnerët brenda dhe jashtë sistemit të burgjeve, si: Institucione qeveritare, organizata të shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe aktorëve të tjerë të përfshirë në fushën e promovimit dhe monitorimit të respektimit të të drejtave njeriut në sistemin e burgjeve, me qëllim hartimin e politikave dhe planeve me konsensus më të gjerë.

Parimet që përshkojnë këtë strategji, analizuar në këndvështrimin e ofruesit dhe përfituesit të shërbimeve janë:

1. Përgjegjshmëria ndaj ligjit;
2. Respekti për dinjitetin njerëzor;
3. Humanizmi;
4. Transparenca;
5. Paanësia dhe objektiviteti;

Strategjia e hartuar është e ndarë në kapituj, të cilët përmbajnë:

1. Kushtet aktuale: kuadri ligjor dhe institucional;
2. Vizionin dhe prioritetet;
3. Burimet;
4. Llogaridhënia, monitorimi dhe analiza vlerësuese.

KAPITULLI 1

KUSHTET AKTUALE

1.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni i BE në fushën e të drejtave të njeriut në burgje është i përbërë nga aktet ligjore të mëposhtme:

- Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi Rec (2006) 2 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 11 janar 2006 në takimin e 952-të të zëvendës ministrave).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2008) 11 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare mbi rregullat evropiane për të miturit nënshirohen sanksioneve ose masave (të miratuar nga Komiteti i Ministrave më 5 2008 at nëntor 1040 takimi i zëvendës ministrave).
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2012) 5 i Komitetit të Ministrave për Shtetet anëtare mbi Kodin Evropian të Etikës për stafin e burgjeve (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 12 prill 2012at takimi 1140 të zëvendës ministrave)
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (98) 71 i i Komitetit të Ministrave të Shteteve anëtare lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg (të miratuara nga komiteti i ministrave më 8 prill 1998 në takimin e 627 të zëvendës ministrave)
- Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec (2004) 10 i Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit të personave me çrregullime mendore.

Kushtetuta e RSH i rendit në mënyrë të hollësishme të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kushtetuta e ka veçuar Konventën Evropiane nga tërësia e normave ndërkombëtare. Neni 17 i Kushtetutës vendos barazinë juridike të Konventës me Kushtetutën për sa i takon kufizimit të drejtave dhe lirive themelore. Kushtetuta ka njohur epërsinë e marrëveshjeve ndërkombëtare ndaj ligjeve të vendit. Në Kushtetutë, në kreun mbi liritë dhe të drejtat vetjake, janë parashikuar, midis të drejtave të tjera, edhe të drejtat e personit në procesin penal, si:

1. E drejta e personit që i hiqet liria, të njoftohet menjëherë në gjuhen që ai kupton, për shkaqet e kësaj mase si dhe për akuzën që i bëhet;
2. E drejta të komunikojë menjëherë me avokatin e tij;
3. E drejta e trajtimit njerëzor dhe e respektimit të dinjitetit të personit etj.

Ligji Nr. 8328, date 16. 04. 1998, "Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim" i ndryshuar, ka përcaktuar qëllimin e tij sipas të cilit, për të paraburgosurit dhe të dënuarit duhet të realizohet një trajtim që synon rehabilitimin për integrimin e tyre në jetën shoqërore. Ligji përcakton programimin dhe realizimin e trajtimit, individualizimin e trajtimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar, llojet e institucioneve për ekzekutimin e dënimeve penale, trajtimin mjekësor etj.

Ligji nr. 10032, datë 11.12.2008 "Për Policinë e Burgjeve" sanksionon procedurat për punësimin, përcaktimin e detyrave, përgjegjësi, sistemin e gradave, në dhënien e masave disiplinore punonjësve të policisë së burgjeve.

Në bazë të ligjit të sipërpërmendur është miratuar Nr. 303, datë 25.3.2009 ndryshuar me V.K.M-në nr. 187 date 17.03.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 303 datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve".

1.2 Kuadri institucional

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bazë të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", i ndryshuar, është institucion në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ndjek dhe drejton organizimin dhe funksionimin e sistemit të burgjeve dhe të paraburgimit, ekzekutimit të vendimeve penale, në funksion të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve. Misioni i DPB është të garantojë sigurinë, trajtimin human dhe kushtet e nevojshme për rehabilitimin social dhe ri-integrimin në shoqëri të shtetasve të paraburgosur dhe të dënuar. Prioritet për DPB-në është përmirësimi i kushteve standarde dhe trajtimittë personave të privuar nga liria në përputhje me politikat e qeverisë shqiptare, si dhe përafrimin e tyre me standardet e BE. DPB-ja organizon, menaxhon dhe kontrollon të gjitha institucioneve penitenciare (22) në varësi të saj. Burgjet dhe paraburgimet përbëjnë autoritetet administrative të cilat zbatojnë vendimet e Gjykatës për mbrojtjen dhe mbikëqyrjen e personave të dënuar dhe të paraburgosur, duke garantuar trajtimin njerëzor dhe me dinjitet. Aktualisht janë 19 burgjeve dhe qendrave të paraburgimit në vendin tonë, 1 Institucion Special të Shëndetësisë për të burgosurit e dënuar dhe të paraburgosur në Tiranë, 1 Institucion për të Miturit në Kavajë dhe 1 Institucion Special në Krujë për trajtimin e të burgosurve me sëmundje kronike dhe të moshuarit. Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, kanë për detyrë pranimin, garantimin e sigurisë, rehabilitimin dhe ri-integrimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve. DPB ka të punësuar 3766 punonjës.

1.3 Kushtet aktuale

Respektimi dhe mbrojtja e të Drejtave Themelore të Njeriut, duhet të jetënë përputhje me kërkesat dhe detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), veçanërisht kërkesat që rrjedhin nga Pjesa I mbi Parimet e Përgjithshme, duke iu referuar nenit 2 dhe nga Titulli VI mbi Përafrimin e Ligjeve dhe Zbatimin e Ligjit, me referencë të posaçme në nenin 70: *"Duke marrë parasysh angazhimin e Palëve për rritjen e lirive politike e ekonomike që janë bazat themelore të kësaj marrëveshjeje, si dhe angazhimin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe shtetin e së drejtës, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin minoriteteve kombëtare, si dhe parimet demokratike nëpërmjet një sistemi shumë partiak me zgjedhje të lira e të ndershme....Respekti për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut, siç janë shpallur në Deklaratën Universale të së Drejtave të Njeriut dhe siç janë përkufizuar në Konventën Evropiane të Drejtave të Njeriut, në Aktin Final të Helsinkit dhe në Kartën e Parisit për një Evropë të Re, respekti për parimet e së drejtës ndërkombëtare, ato të shtetit të së drejtës si edhe për parimet e ekonomisë së tregut, siç pasqyrohen në Dokumentin e Konferencës së Bonit të KSBE-së për Bashkëpunimin Ekonomik, formojnë bazën e politikave të brendshme dhe të jashtme të Palëve dhe përbëjnë elementët thelbësorë të kësaj Marrëveshjeje....Palët njohin rëndësinë e përafrimit të legjislacionit ekzistues shqiptar me atë të Komunitetit dhe zbatimin e tij efektiv. Shqipëria do të përpiqet të sigurojë që ligjet e saj ekzistuese dhe legjislacioni i ardhshëm të shkojë gradualisht drejt përputhjes me legjislacionin e Komunitetit. Shqipëria do të sigurojë që legjislacioni ekzistues dhe i ardhshëm do të zbatohet siç duhet."*

Opinionit i Komisionit Evropian mbi aplikimin e Shqipërisë për anëtarësim (2013)^[1] vuri theksin në mënyrë të veçantë në sektorin e të drejtave themelore. Raporti i Progresit thekson se: *"Shqipëria ka ndërmarrë disa hapa konkretë për të përforcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe për të zbatuar në mënyrë efektive politikat kundër diskriminimit – të dy këto fusha janë ndër përparësitë kryesore. Masat janë marrë për forcimin e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit, një tjetër fushë e mbuluar nga një prioritet kyç i Opinionit (Komisioni Evropian 2013 : 41) . "Në disa fusha të drejtave themelore, kuadri ligjor është përmirësuar dhe janë marrë disa hapa inkurajuese praktike Shumë nga rekomandimet e Avokatit të Popullit mbi keqtrajtimet janë adresuar nga burgjet; prioritet kyçe lidhur me trajtimin e të burgosurve janë përmbushur (Komisioni Evropian 2013: 46).*

^[1]Dokument i stafit tëpunës të Komisionit, Raporti i Progresitpër Shqipërinë, 2013,që shoqëronDokumentin e Komunikimit nga Komisioni drejtuar Parlamentit Evropian dhe Këshillit. Strategjia e Zgjerimitdhesfidat kryesore2013-2014{com (2013) 700final}, Bruksel, 2013/10/16. SËD(2013) 414final.

Raporti i Progresit 2013, nënvizon se përveç zhvillimeve dhe reformave të bëra në sistemin e burgjeve, çështje të rëndësishme mbeten të pa adresuara. Këto çështje ishin:

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe infrastrukturës së institucioneve penitenciare;
- Hetimi në rastet e shkeljes së ligjit;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për shpërblimin për punën e të burgosurve;
- Ulja e mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Përmirësimi i shërbimit shëndetësor dhe trajtimit të personave me çrregullime të shëndetit mendor;
- Përmirësimi i përgatitjes profesionale të punonjësve të institucioneve të vuajtjes së dënimit;
- Forcimi i luftës kundër korrupsionit në burgje.

Ndërkohë prej disa vitesh tregues të rëndësishëm matës të zhvillimit të reformës në sistemin e burgjeve, mbeten raportet e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues ose Ndëshkimit (KPT). Gjatë vizitës së fundit në Shqipëri (4-14 Prill 2014), Delegacioni i KPT konstatoi disa problematika në sistemin e burgjeve, si:

- Niveli i lartë i mbipopullimit;
- Kushte jo higjienike dhe infrastrukturë jo sipas standardeve, veçanërisht në dhomat e observimit;
- Hapësirë e pamjaftueshme dhe mungesë e pajisjeve dhe shtresave të jetesës në qelitë e të burgosurve;
- Mungesë aktiviteteve dhe kohë e reduktuar e qëndrimit jashtë qelisë, veçanërisht për të miturit; mungesë e mjekëve psikiatër;
- Trajtim i papërshtatshëm i personave të deklaruar të papërgjegjshëm memasëmjekim të detyrueshëm;

Mbështetur në këto problematika KPT parashtroi si prioritet nevojën për zhvillimin e mëtejshëm të reformës në sistemin e burgjeve, për përmirësimin e respektimit të drejtave të personave me liri të kufizuar.

KAPITULLI 2

VIZIONI DHE PRIORITETET

2.1 Vizioni

Sistemi i burgjeve ka për mision të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut. Bazuar në arritjet e deritanishme dhe potencialet për ndërmarrjen e reformave në vijimësi, Strategjia Afatmesme e Sistemit të Burgjeve përcakton vizionin e mëposhtëm:

Strategjia Afatmesme për Sistemin e Burgjeve përcakton këtë vizion:

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve do të sigurojë për shoqërinë një sistem penitenciar eficient, nëpërmjet garantimit të zbatimit të ligjit, transparencës dhe respektit për dinjitetin njerëzor.

Realizimi i vizionit strategjik do të arrihet nëpërmjet zbatimit të objektivave konkrete të përcaktuar në përmbajtje të këtij dokumenti, të tilla si: zhvillimi dhe konsolidimi i sistemit të burgjeve bazuar në respektin për liritë dhe të drejtat themelore të paraburgosurve dhe të dënuarve; harmonizimit të legjislacionit me *acquis* të BE-së; administrimit me efikasitet dhe rritjes së besimit të publikut në respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve; parandalimit dhe eliminimit të akteve korruptive; transparencës, përgjegjshmërisë dhe efikasitetit në funksionimin e sistemit të burgjeve; zbatimit të ligjit dhe mbarëvajtjes së reformës; bashkëpunimit ndërinstitucional me institucione shtetërore dhe NGO të ndryshme.

2.1 Prioritetet

Prioritetet dhe qëllimet strategjike për sistemin e burgjeve për t'u realizuar deri në vitin 2017 janë përcaktuar në zbatim të politikave të Qeverisë Shqiptare për sistemin e burgjeve, mbështetur në ecurinë e deritanishme të reformës së sistemit të burgjeve.

Prioritete konsistojnë në mënyrë të përmbledhur në zbatimin e objektivave strategjike të listuara si më poshtë:

1. Përqasja e legjislacionit të sistemit të burgjeve në përputhje me legjislacionin e BE.

1.1 Përmirësimi i akteve ligjore dhe nënligjore

- 1.1.1 Hartimi i ndryshimeve në Ligjin "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (2014);
- 1.1.2 Hartimi i ndryshimeve në Ligjin "Për policinë e burgjeve" (2014);
- 1.1.3 Hartimi i ndryshimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve (2014);
- 1.1.4 Hartimi i Rregulloreve të re të disiplinës dhe kodin e etikës për policinë e burgjeve (2014);
- 1.1.5 Hartimi i Rregulloreve të re të disiplinës dhe kodin e etikës për stafin civil (2014);
- 1.1.6 Hartimi i Rregulloreve të reja për IEVP (2015);

2. Përmirësimi i shërbimeve të ofruar për kategorinë e personave me liri të kufizuar, mbështetur në trajtimin human dhe jo-diskriminues.

2.1 Ulja e mbipopullimit në sistemin e burgjeve dhe paraburgimeve.

- 2.1.1 Hapja e institucioneve të reja të burgut dhe paraburgimit(2014-2017);
- 2.1.2 Hartimi i planeve të studiuara për transferimin e të burgosurve (2014-2017);
- 2.1.3 Forcimi i bashkëpunimit me shërbimin e provës (2014-2017)

2.2 Përmirësimi i shërbimit shëndetësor për personat me liri të kufizuar.

- 2.2.1 Përmirësimi i sigurimit të medikamenteve (2014);
- 2.2.2 Shtimi në organikë të mjekëve psikiatër në IEVP me kapacitet të lartë (2014);
- 2.2.3 Kalimi në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, i shtetasve me vendim gjykate “Mjekim i detyruar” dhe “Shtrim i Përkohshëm” (2014);
- 2.2.4 Hapja e Sektorëve të Kujdesit të Veçantë për personat me çrregullime të shëndetit mendor në sistemin e burgjeve (2014-2015);
- 2.2.5 Kalimi i IVSHB në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë (2014);
- 2.2.6 Realizimin e depistimeve për sëmundjet infektive, në bashkëpunim me ISHP (2014-2017);
- 2.2.7 Shtimi në organikën e IVSHB të mjekëve specialistë (nefrolog, endokrinolog, gastro-hepatolog) (2015);
- 2.2.8 Përmirësimi i trajtimit të specializuar për riaftësimin shëndetësor (2015);
- 2.2.9 Kalimi i shërbimit shëndetësor të sistemit të burgjeve në varësi të MSH (2016).

2.3 Rritja e standardeve të trajtimit ushqimor, për personat me liri të kufizuar;

- 2.3.1 Rritja dhe përmirësimi i normës ushqimore (2014);
- 2.3.2 Nxitja e iniciativave private për ofrimin e shërbimit ushqimor (2017);

2.4 Përmirësimi i procesit të rehabilitimit social dhe ri-integrimit në shoqëri të personave me liri të kufizuar:

- 2.4.1 Përmirësimi i programeve të individualizuara të trajtimit për kategoritë specifike (2014);
- 2.4.2 Hartimi i programeve të ri-integrimit, me fokus kategoritë në nevojë si të miturit, gratë, 18-21 vjeçarët dhe personat pa mbështetje nga familja(2014);
- 2.4.3 Bashkëpunimi me institucione/aktorë lokale për ndërtimin e rrjeteve mbështetëse pas lirimit (2014-2015);
- 2.4.4 Orientimi i sistemit të burgjeve drejt praktikave më të mira evropiane për ofrimin e shërbimeve cilësore (2014-2017);

2.5 Krijimi i një sistemi efektiv për punësimin dhe shpërblimin për punën e të dënuarve/të paraburgosurve.

- 2.5.1 Vënia në funksionim e Komisionit të Përhershëm të Vlerësimit të Punës në Burgje (2014);
- 2.5.2 Hartimi i politikave të përshtatshme në fushën e punësimit të burgosurve (2014);
- 2.5.3 Hartimi i akteve nënligjore për zbatimin e skemës së shpërblimit për punën e të burgosurve (2014);
- 2.5.4 Nxitja e iniciativave private për punësimin e të burgosurve (2014);
- 2.5.5 Bashkërendimi i veprimtarisë së punës me institucionet shtetërore dhe subjektet e tjera me qëllim punësimin dhe shpërblimin e drejtë të burgosurve (2014-2015);
- 2.5.6 Nxitja e punës kërkimore për gjetjen e zgjidhjeve dhe zbatimin e metodave bashkëkohore për punësimin e të burgosurve (2015-2016).

2.6 Rritja e performancës së punonjësve të sistemit të burgjeve

- 2.6.1 Qartësimi i kompetencave dhe detyrave funksionale (2014);
- 2.6.2 Ngritja e një komisioni për vlerësimin e performancës së IEVP (2014);
- 2.6.3 Përmirësimi të kurrikulës së trajnimeve dhe vlerësimit (2014);
- 2.6.4 Zhvillimi i trajnimeve specifike për stafet që punojnë me të miturit, gratë dhe personat me çrregullime të shëndetit mendor (2014-2017);
- 2.6.5 Përpilimi i një plani të strukturës së personelit mbi bazën e llogaritjeve të raporteve personel/ të burgosur (2015);
- 2.6.6 Përfshirja e personelit të burgjeve në fushën e punës kërkimore shkencore (2014-2017).

3. Përmirësimi i infrastrukturës fizike, materiale dhe teknologjisë së sistemeve burgjeve.

3.1 Ngritja e burgjeve dhe qendrave të reja të paraburgimit

- 3.1.1 Vënia në shfrytëzim të institucioneve të reja të Burgut dhe Paraburgimit në Berat, Fier dhe Shkodër (2014-2015);
- 3.1.2 Hartimi i një plani masash lidhur me verifikim paraprak të saktësisë së projekteve për qarkun Gjirokastrë dhe Dibër (2015);
- 3.1.3 Planifikimi në kohë të fondeve për TVSH dhe Taksë Doganore në mbështetje të projekteve për burgjet e reja (2014);
- 3.1.4 Identifikimi i rreziqeve që kanë të bëjnë me zbatimin dhe ndjekjen e këtyre

projekteve (2015);

- 3.1.5 Ndjekja e projekteve dhe zbatimit të investimeve me financim të BE-së dhe donatorëve të tjerë (2014-2015);
- 3.1.6 Koordinimi i bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Financave, për zbatimin e këtyre projekteve (2015);

3.2 *Përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve aktuale.*

- 3.2.1 Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe materiale në institucionet/ sektorët për të miturit (2014);
- 3.2.2 Rikonstruksioni i Burgut 313 Tiranë, Burgu Burrel, Burgu Lezhë (2015);
- 3.2.3 Përmirësimi i standardeve në paraburgimet e marra nga komisaritet: Sarandë, Tropojë dhe Kukës (2015);
- 3.2.4 Realizimi i sistemeve të ngrohjes qendrore në IEVP Peqin dhe Lezhë (2015-2017);
- 3.2.5 Përmirësimi i sistemit të furnizimit me energji elektrike dhe sigurimi i burimeve paralele të furnizimit, në IEVP Fushë-Krujë, Lezhë (2014-2017);
- 3.2.6 Përmirësimi i kushteve materiale për të dënuarit. (2014-2016);
- 3.2.7 Përmirësimi i kushteve higjieno-sanitare (2014-2017);

3.3 *Modernizimi i teknologjisë në sistemin penitenciar*

- 3.3.1 Ndërtimi i aplikacionit WEB për kartelat e të dënuarve dhe të personelit (2015);
- 3.3.2 Informatizimi i proceseve të punës së arkivë protokollit (2015-2017);
- 3.3.3 Informatizimi i sistemit të burgjeve (2015-2017);
- 3.3.4 Rikonstruksioni i dhomës së serverave (2015);
- 3.3.5 Përmirësimi i infrastrukturës së IT në sistemit të burgjeve (2015-2017);

4. Përmirësimi i sigurisë në sistemin e burgjeve.

4.1 *Përmirësimi i elementeve të sigurisë në sistemin e burgjeve*

- 4.1.1 Ripunimi i skemave të sigurisë për të gjitha burgjet e paraburgimet në bazë të organikave të reja (2014);

4.2 *Modernizimi i teknologjisë së sistemit të komunikimit dhe mbikëqyrjes*

- 4.2.1 Dixhitalizimi i sistemit të mbrojtjes perimetrike dhe kamerave për IEVP Burrel, Rrogozhinë, Tepelenë, Lushnjë F.Krujë, Lezhë, Fier, Mine Peza, Burrel, Fier dhe Shkodër (2015-2017);
- 4.2.2 Dixhitalizimi i sistemit të komunikimit (2015-2017);

- 4.2.3 Dixhitalizimi i sistemit të kontrollit dhe pajisjeve vëzhguese (2015-2017);
- 4.2.4 Zbatimi i sistemit të mbikëqyrjes elektronike për të dënuarit për rastet e lejeve jashtë institucionit (2017);

5. Rritja e partneritetit për respektimin e të drejtave të njeriut në sistemin e burgjeve.

5.1 *Përmirësimi i marrëdhënieve me publikun*

- 5.1.1 Reformimi i shërbimeve publike (2014-2017);
- 5.1.2 Rritja e aksesit të publikut në njohjen e legjislacionit për sistemin e burgjeve (2014-2017);

5.2 *Rritja e bashkëpunimit me institucione shtetërore*

- 5.2.1 Rinovimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (2014);
- 5.2.2 Rinovimi i marrëveshjes së bashkëpunimit me MMSR për procesin e formimit profesional në IEVP (2014);
- 5.2.3 Bashkëpunimi me institucione dhe agjenci shtetërore në nivel lokal (2014-2015);

5.3 *Rritja e bashkëpunimit me Avokatin e Popullit*

- 5.3.1 Krijimi i aksesit të plotë për monitorim nga Avokati i Popullit (2014-2017);
- 5.3.2 Hartimi dhe zbatimi i Planeve të Veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit (2014-2017);
- 5.3.3 Mbajtja e një sistemi database me të dhëna statistikore mbi numrin e inspektimeve të kryera nga Avokati i Popullit dhe numrin/përqindjen e rekomandimeve të trajtuara (2014-2017);

5.4 *Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile*

- 5.4.1 Bashkëpunimi për identifikimin e prioriteteve në funksion të zbatimit të projekteve të përbashkëta (2014-2017);
- 5.4.2 Rritja e aksesit për monitorimin e institucioneve penitenciare (2014-2017);
- 5.4.3 Hartimi i Planeve të Veprimit në funksion të adresimit për zgjidhje të rekomandimeve të OJF-ve (2014-2017);
- 5.4.4 Forcimi i rolit të aktorëve/individëve profesionistë ndihmës të sistemit të burgjeve (2014-2017);

6. Eliminimi i akteve korruptive dhe fenomeneve të tjera negative në sistemin e

burgjeve.

6.1 *Përmirësimi i procedurave anti-korrupsion*

- 6.1.1 Hartimi i rregullave antikorrupsion (2014);
- 6.1.2 Zhvillimi i një mekanizmi të qëndrueshëm dhe transparent për adresimin e ankesave mbi aktet korruptive në sistemin e burgjeve (2014);
- 6.1.3 Krijimi i database për dokumentimin e rasteve korruptive (2014);
- 6.1.4 Forcimi i adresimit për ndjekje ligjore të rasteve të korrupsionit në administratën e burgjeve (2014-2017);

6.2 *Konsolidimi i mekanizmit të auditimit të brendshëm për identifikimin e akteve korruptive*

- 6.2.1 Përmirësimi i rregullave të auditimit të brendshëm (2014);
- 6.2.2 Monitorimi i përdorimit të burimeve financiare nëpërmjet auditimeve (2014-2017);
- 6.2.3 Kryerja e auditeve tematike lidhur me efektivitetin e kryerjes së shpenzimeve për blerje mallrash me të tretë, si dhe për kryerjen e investimeve (2014-2017);
- 6.2.4 Trajnimi i stafit të auditit (2014);
- 6.2.5 Hartimi i programeve për kryerjen e auditeve në subjektet e programuara sipas frekuencës së miratuar në manualin e auditit (2015);

KAPITULLI 3

BURIMET

Referenca që lidhen me nevojat për përdorimin e burimeve financiare është kryer me planet buxhetore të planifikuara në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI), si dhe Programin buxhetor afatmesëm (PBA).

Gjithashtu, në identifikimin e nevojave për burime financiare, një vend të rëndësishëm do të zënë dhe projektet e huaja në kuadër të Instrumentit të Paraaderimit (IPA), si dhe detyrimet e dala në kuadër të procesit integruar të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Strategjia Afatmesme e Burgjeve dhe plani i saj i veprimit do të jenë subjekt i vazhdueshëm rishikimi dhe do të sigurojnë bazën e informacionit për përcaktimin e taveve buxhetore, mbështetur në nevojat për financime nga buxheti i shtetit apo përmes financimeve të huaja.

EVIDENCA E SHPENZIMEVE BUXHETORE MUAJI DHJETOR 2014

Drejtoria e Përgjithshme e Bursjeve																
KOD	GR	PROG	KAI	PROJEKT	ART	PLAN VJETOR	PL THESARI	SHPENZ THESARI	DEBIT 466	TRANSF 604	SHPENZ B.SH	Fatura te	XH. BRËNDSH	BANKA	SHPENZ - BANKA	NR. FUNONJËS.
								I	J	K	L	M	N	O=i+j-k-l-m-n	P=I-O	PLAN FAKT
1014048	14	3440	1	Paga & shpërblime	600	129.713.200		128.200.075						101.597.593	-	163
1014048	14	3440	1	Sigurime shoqërore & shëndetësore	601	21.376.000		21.062.411					21.062.411	-	-	
					6009999		151.089.200								-	
1014048	14	3440	1	Shpenzime Operative	602	703.439.535		654.159.917			26.352	38.473.441		615.660.124	-	
1014048	14	3440	1		603									-	-	
1014048	14	3440	1		604									-	-	
1014048	14	3440	1		605									-	-	
1014048	14	3440	1	Transferste për buxhete familjare &	606	2.605.290		538.941					20.974	517.967	-	
					6029999		706.044.825								-	
1014048	14	3440	1	M140027	230	3.622.160		3.622.160						3.622.160	-	
1014048	14	3440	1	M140227(pejdisje)	231	10.000.000		8.335.560						8.335.560	-	
1014048	14	3440	1	M140228(nderitimore)	231	5.000.000		3.513.269		172.036				3.341.233	-	
1014048	14	3440	1	M140182	231	662.181								-	-	
1014048	14	3440	1	M140187	231									-	-	
1014048	14	3440	1	M140188	231									-	-	
1014048	14	3440	1	M140189	231									-	-	
1014048	14	3440	1	M140190	231									-	-	
1014048	14	3440	2	CM14018	231									-	-	
1014048	14	3440	3	M140184	231									-	-	
1014048	14	3440	4	M140185	231									-	-	
					2319999		19.284.341								-	
				SHUMA		876.418.366		819.432.333		172.036	26.352	38.473.441	47.685.867	733.074.637	-	
1014048	14	3440	6		466				8.313.958					8.313.958		
				TOTALI		876.418.366	876.418.366	819.432.333	8.313.958	172.036	26.352	38.473.441	47.685.867	741.388.595	-	
827.746.291																

827.746.291

827.746.291

EVIDENCA E SHPENZIMEVE BUXHETORE MUAJI DHJETOR 2015

Drejtoria e Përgjithshme e Bursjeve																			
KOD	GR	PROG	KAI	PROJEKT	ART	PLAN VJETOR	PL THESARI	SHPENZ THESARI	DEBIT 466	TRANSF 604	SHPENZ B.SH	Fatura te Papaguara	XH. BRENDISH	BANKA 2015	Fatura te paguara 2014 Banka	DIF SHPENZ - BANKA	NR. FUNKIONES		
								I	J	K	L	M	N	O=I+J-K-L-M-N		P=I-O	PLAN	FAKT	
1014048	14	3440	1	Paga & shperblime	600	149.401.900		141.108.353					29.498.991	111.609.362		111.609.362	192	184	
1014048	14	3440	1	Sigurime shoqërore & shëndetësore	601	24.926.230		22.879.131					22.879.131	-		-			
					6009999		174.328.130							-		-			
1014048	14	3440	1	Shpenzime Operative	602	778.253.852		715.286.051				78.072	1.089.909	714.118.070	38.473.442	752.591.512			
1014048	14	3440	1		603									-		-			
1014048	14	3440	1		604									-		-			
1014048	14	3440	1		605									-		-			
1014048	14	3440	1	Transferente per buxhetet familjare &	606	335.000		284.114						284.114		284.114			
					6029999		778.588.852							-		-			
1014048	14	3440	1	M140027	230									-		-			
1014048	14	3440	1	M140059(automjete)	231	14.414.400		3.206.400						3.206.400		3.206.400			
1014048	14	3440	1	M140228(indertimor)	231									-		-			
1014048	14	3440	1	M140154 (pajisje SB)	231	3.585.600		1.427.800						1.427.800		1.427.800			
1014048	14	3440	1	M140182	231									-		-			
1014048	14	3440	1	M140188	231									-		-			
1014048	14	3440	1	M140189	231									-		-			
1014048	14	3440	1	M140190	231									-		-			
1014048	14	3440	2	GM14018	231									-		-			
1014048	14	3440	3	M140184	231									-		-			
1014048	14	3440	4	M140185	231									-		-			
					2319999		18.000.000							-		-			
				SHUMA		970.916.982		884.191.849		-		78.072	1.089.909	52.378.122	830.645.746	38.473.442	869.119.188		
1014048	14	10000	00		466				4.056.444					4.056.444		4.056.444			
				TOTALI		970.916.982		884.191.849	4.056.444	-			78.072	1.089.909	834.702.190	38.473.442	873.175.632		

Shtojca 1/A			Pasqyra Shtesë për Buxhetin Vjetor												PBA 2017-2019											
Pasqyra Nr.2: Përmblendhëse e Kërkesave Buxhetore			VITI 2016 (I RISHIKUAR)												Ne 000 leke											
			Ministria/Institucioni Buxhetor/Grupi		Kodi	Përshkrimi																				
					14 / 03440	Sistemi i Burgjeve																				
Grupi	Titulli	Kapitulli	Përshkrimi			600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali											
001	14	01			Pagat	Kontrib. e Sigurimeve Shoqerore	Mallra dhe Sherbime	Subvencionet	Te Tjera Transfer. Korrente Brendshme	Transfer. Korrente te Huaja	Transferta per Buxhetet Familjare dhe Individidet	Shpenzime Kapitale te Patrupezuara	Shpenzime Kapitale te Trupezuara													
					2.784.956	472.564	1.129.380	0	0	350	0	40.000	835.878	5.263.128												
					2.784.956	472.564	1.129.380	0	0	350	0	40.000	835.878	5.263.128												
					2.784.956	472.564	1.129.380	0	0	350	0	40.000	340.302	4.767.552												
													155.000	155.000												
													290.576	290.576												
													50.000	50.000												
														0												

Shtojca 1/A Pasqyra Shtesë për Buxhetin Vjetor

Pasqyra Nr. 5: Parashikimi i Shpenzimeve për Mallra dhe Shërbime për secilin Program të Ministrive të Linjës (602)

PBA 2017-2019

Në 000 lekë

		Kodi	Emërtimi
Ministria/ institucioni buxhetor	14 / 03440		SISTEMI I BURGJEVE

Nënkategoria		602		Mallra dhe shërbime të tjera						
Artikulli	Emërtimi	Fakt vitit 2015		I pritshmi 2016		Parashikimi vitit 2017			2018	2019
		Buxheti	Nga te ardhurat	Buxheti	Nga te ardhurat	Limiti	Kerkesa shtese	Nga te ardhurat		
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
	1 SISTEMI I BURGJEVE									
6020	Materiale dhe Sherbime te pergjithshme zyre	35.397	0	43.509	0	46.980	2.800	0	41.610	41.610
6021	Materiale dhe Sherbime sociale	512.598	0	603.473	0	648.241	164.870	0	641.383	141.383
6022	Sherbime	247.541	0	295.909	0	335.203	115.640	0	278.431	278.431
6023	Shpenzime transporti	77.054	0	90.406	0	90.930	0	0	90.930	90.930
6024	Shpenzime udhetimi	28.150	0	11.910	0	12.000	3.000	0	12.000	12.000
6025	Mirembajtje te zakonshme	22.369	0	32.414	0	10.476	18.820	0	10.476	10.476
6026	Qeradenie	3.822	0	4.631	0	6.320	0	0	6.320	6.320
6027	Detyrime dhe kompensime legale	99.986	0	44.582	0	0	30.000	0	0	0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	0	0	0	0					
6029	Shpenzime te tjera operative	1.058	0	2.547	0	0	2.800	0	0	0
	Total:	1.027.976		1.129.380		1.150.150	337.930	0	1.081.150	581.150
		Shuma e tavanit plus kërkesat që nuk mbulojnë (Gjithsej duhen)								
							1.488.080			

Shtojca 1/A

Pasqyra Shitesë për Buxhetin Vjetor

Pasqyra Nr.2: Përmbledhëse e Kërkesave Buxhetore

VITI 2017

PBA 2017-2019

Ne 000 leke

Kodi	Përshkrimi
14 / 03440	Sistemi i Burgjeve

Grupi	Titulli	Kapitulli	Përshkrimi	600	601	602	603	604	605	606	230	231	Totali
001	14	01											
			SISTEMI I BURGJEVE										
			1 Çelje nga Buxheti i Përgjithshëm	3.036.675	507.125	1.150.150	0	0	350	0	0	642.700	5.337.000
			2 Financim i Huaj	3.036.675	507.125	1.150.150	0	0	350	0	0	642.700	5.337.000
			3 Kostot Lokale për Projektet me Financim të Huaj									342.700	5.037.000
			4 Mbulimi i TVSH, Detyrimeve Doganore									300.000	300.000
			5 Shpenzime nga të Ardhurat										0



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Afati i Ruajtjes _ vit
Kopje nr. _____

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2016

**Plan Veprimi për Zbatimin e Masave dhe Rekomandimeve të Kontrollit të
Lartë të Shtetit**

I. Hyrje

1. Me shkresën nr. 1132/8 datë 28.03.2016 Kontrolli i Lartë i Shtetit përcolli raportin e auditimit të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve. Auditimi filloi më datë 15.12.2015 dhe ka përfunduar më datë 20.02.2016.

2. Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Kontrolli i Lartë i Shtetit konstatoi disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi. Në zbatim të nenit 15 të ligjit r. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" për përmirësimin e situatës janë rekomanduar dhe janë lënë disa masa për zbatim.

3. Janë lënë për zbatim masa organizative, masa shpërblim dëmi dhe masa disiplinore për zbatim me afate të ndryshme, si më poshtë:

1. Institucioni të ketë një politikë më të kujdesshme të programimit dhe ndjekjes së zërave buxhetor, duke shpenzuar fonde vetëm brenda limiteve të përcaktuara dhe për të gjitha rialokimet të ketë një raportim të kujdesshëm dhe monitorim të zërave buxhetor.

Menjëherë

2. Institucioni të marrë masa për të realizuar fondet jo duke i postuar në fund të vitit pasi kjo sjell jo vetëm mos efektivitet, por edhe mungesë efçente të përdorimit të fondeve. Nga ana tjetër duhet të ketë një vëmendje të shtuar për nivelin e detyrimeve që krijohen jo vetëm nga mungesa e likuiditetit por edhe nga probleme të administrimit. Menjëherë

3. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të rishikojë vartësinë e Sektorit të Arkiv Protokollit duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9154 datë 06.11.2013 "Për arkivat".

4. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të ngrejë një grup pune për të hartuar një Rregullore të Posaçme, e cila të reflektojë kërkesat e ligjit për arkivat si dhe të normave tekniko profesionale, duke parashikuar saktë në të praktikat dhe modelet

standarde të punës të Sektorit të protokoll arkivit.

5. Të ngrihet një komision i ekspertizës i cili të hartojë listat e dokumenteve me rëndësi kombëtare dhe të dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme, duke përcaktuar për këto të fundit afatet e ruajtjes.

6. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të hartojë listat e veçimit si dhe të përcaktojë saktë në to listën e atyre dokumenteve, për të cilat ka kaluar fati i ruajtjes, si dhe të procedojë me procedurat e asgjësimit të tyre, duke vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale. Të bëhet evidentimi i dokumenteve të cilat duhen dorëzuar pranë arkivit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të nisë praktikën shkresore për të kryer dorëzimin e dokumenteve. **Brenda datës 31.12.2016**

7. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të hartojë një plan kontrolli periodik vjetor me qëllim përmirësimin e punës dhe evidentimin e problematikave në lidhje me funksionimin e sektorit të protokoll arkivit.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të marrë masa për t'i siguruar sektorit të protokoll arkivit mbështetje tekniko-profesionale dhe metodologjike në lidhje me specifikat e punës arkivore dhe të protokollit. **Menjëherë dhe vazhdimisht**

9. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të procedojë me arkivimin e dosjeve të auditimit të brendshëm në zbatim të dispozitave të ligjit për arkivat dhe normave tekniko-profesionale. **Brenda 30.04.2016**

10. Të merren të gjitha masat e duhura në përputhje me dispozitat ligjore për statusin e nëpunësit civil, për plotësimin e organikës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm me qëllim mos cenimin e funksionimit normal të një strukture të rëndësishme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. **Brenda 31.12.2016**

11. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa me qëllim që të hartojë procedura të sakta në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe me Manualin e Auditimit të Brendshëm, të përgatitur nga Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë, për të kryer rishikimin në të ftohtë dhe në të nxehtë të punës audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. **Brenda 31.12.2016**

12. Detyrimet financiare për pagat e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të regjistroheshin në kontabilitetin përkatës të DPB. Me paraqitjen e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, DPB të marrë masat e nevojshme duke vendosur detyrat konkrete për çdo hallkë të institucionit, për zbatimin vullnetar të vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Në të kundërt personat përgjegjës të zhdëmtojnë vlerën e shpenzimeve përmbartimore. **Në vazhdimësi**

13. DPB, me qëllim shmangien e pagesës për të njëjtën periudhë në dy vende pune shtet/ose privat gjatë zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të verifikojë në bashkëpunim me institucione të tjera, ose minimalisht të kërkojë/pranojë një deklaram, nëse personi përfitues, objekt i vendimit të gjykatës ka qenë i punësuar në vende të tjera. Në rast se vërtetohet se ka qenë i punësuar, të ndalë menjëherë pagesën dhe për pagesat eventuale të kryera, të bëjë përlllogaritjet dhe të kërkojë kthimin sa më parë të shumave të përfituara padrejtësisht. **Në vazhdimësi**

14. DPB të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave nga personat juridik e fizik debitorë, me qëllim që këto detyrime të realizohen si të ardhura për institucionin, para se të klasifikohen "pa shkresë arkëtimi" dhe të fshihen nga evidenca kontabile. **Menjëherë**

15. Nga sektori i financës të bëhen rregullimet përkatëse të normave të amortizimit në përputhje me ligjin nr. 8438 datë 25.12.1998 "Mbi tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar për të pasqyruar saktë amortizimin e inventarit ekonomik në evidencat kontabël, duke ruajtur jetëgjatësinë normale të tyre dhe evituar zhvlerësimin e parakohshëm të inventarit në përdorim. Sektori i financës dhe buxhetit të kryejë sistemimet e duhura në kontabilitet, në mënyrë që gjendja e aktiveve në pasqyrat financiare, të tregojë realisht

vlerën e aktive të qëndrueshme të institucionit. **Në vazhdimësi**

16. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ngrejë një komision të veçantë për vlerësimin e pjesëve të këmbimit, etj, nëse ekziston mundësia që ato të përdoren dhe në pamundësi, të bashkëpunohet me institucionet shtetërore, për faljen/shitjen e tyre me ankand, etj. **Në vazhdimësi**

17. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për të evituar copëzimin e fondeve gjatë procedurave të prokurimit me vlera të vogla në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "Mbi rregullat e prokurimit publik" të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", të ndryshuar, si dhe të kryejë një parashikim të mirëfilltë të fondeve në fillim të vitit. **Menjëherë**

18. Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 9,785,977 duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe procedurat e tjera në shkallët e gjykimit. **Menjëherë**

19. Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësiive individuale të evidentuara dhe pasqyruara në procesverbalet dhe akt verifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe raportit përfundimtar të auditimit, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore, në raport me shkeljet e kryera.

Plan Veprimi për Zbatimin e Masave dhe Rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit

Nr.	Rekomandimet e lëna	Kryen detyrën
1.	Institucioni të ketë një politikë më të kujdesshme të programimit dhe ndjekjes së zërave buxhetor, duke shpenzuar fonde vetëm brenda limiteve të përcaktuara dhe për të gjitha rialokimet të ketë një raportim të kujdesshëm dhe monitorim të zërave buxhetor.	Spektori i Financës Sektori i Burimeve Njerëzore Sektori i Prokurimeve Sektori Ligjor
2.	Institucioni të marrë masa për të realizuar fondet jo duke i postuar në fund të vitit pasi kjo sjell jo vetëm mos efektivitet, por edhe mungesë efçente të përdorimit të fondeve. Nga ana tjetër duhet të ketë një vëmendje të shtuar për nivelin e detyrimeve që krijohen jo vetëm nga mungesa e likuiditetit por edhe nga probleme të administrimit.	Spektori i Prokurimeve Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve
3.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të rishikojë vartësinë e Sektorit të Arkiv Protokollit duke u bazuar në dispozitat e ligjit nr. 9154 datë 06.11.2013 "Për arkivat".	Spektori i Burimeve Njerëzore
4.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të ngrejë një grup pune për të hartuar një Rregullore të Posaçme, e cila të reflektojë kërkesat e ligjit për arkivat si dhe të normave tekniko profesionale, duke parashikuar saktë në të praktikatat dhe modelet standarde të punës të Sektorit të protokoll arkivit.	Spektori i Protokoll Arkivës Sektori Ligjor
5.	Të ngrihet një komision i ekspertizës i cili të hartojë listat e dokumenteve me rëndësi kombëtare dhe të dokumenteve me afat ruajtje të përkohshme, duke përcaktuar për këto të fundit afatat e ruajtjes.	Spektori i Protokoll Arkivës Sektori Ligjor
6.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa dhe të hartojë listat e veçimit si dhe të përcaktojë saktë në to listën e atyre dokumenteve, për të cilat ka kaluar afati i ruajtjes, si dhe të procedojë me procedurat e asgjësimit të tyre, duke vepruar në përputhje me dispozitat e ligjit për arkivat dhe normat tekniko-profesionale. Të bëhet evidentimi i dokumenteve të cilat duhen dorëzuar pranë arkivit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të nisë praktikatat shkresore për të kryer dorëzimin e dokumenteve	Spektori i Protokoll Arkivës Sektori Ligjor
7.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të hartojë një plan kontrolli periodik vjetor me qëllim përmirësimin e punës dhe evidentimin e problematikave në lidhje me funksionimin e sektorit të protokoll arkivit.	Spektori i Protokoll Arkivës
8.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave të marrë masa për t'i siguruar sektorit të protokoll arkivit mbështetje tekniko-profesionale dhe metodologjike në lidhje me specifikat e punës arkivore dhe të protokollit.	Spektori i Protokoll Arkivës Sektori i Auditit
9.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të procedojë me	Spektori i Protokoll Arkivës

	arkivimin e dosjeve të auditimit të brendshëm në zbatim të dispozitave të ligjit për arkivat dhe normave tekniko-profesionale.	Sektori i Auditit
10.	Të merren të gjitha masat e duhura në përputhje me dispozitat ligjore për statusin e nëpunësit civil, për plotësimin e organikës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm me qëllim mos cenimin e funksionimit normal të një strukture të rëndësishme pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.	Sektori i Burimeve Njerëzore
11.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa me qëllim që të hartojë procedura të sakta në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe me Manualin e Auditimit të Brendshëm, të përgatitur nga Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë, për të kryer rishikimin në të ftohtë dhe në të nxehtë të punës audituese të Njesisë së Auditimit të Brendshëm.	Sektori i Auditit Sektori Ligjor
12.	Detyrimet financiare për pagat e punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatës, të regjistroheshin në kontabilitetin përkatës të DPB. Me paraqitjen e vendimeve të formës së prerë të gjykatave, DPB të marrë masat e nevojshme duke vendosur detyrat konkrete për çdo hallkë të institucionit, për zbatimin vullnetar të vendimeve të formës së prerë të gjykatave. Në të kundërt personat përgjegjës të zhdurojnë vlerën e shpenzimeve përmbartimore.	Sektori Ligjor Sektori i Financës
13.	DPB, me qëllim shmangien e pagesës për të njëjtën periudhë në dy vende pune shtet/ose privat gjatë zbatimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave, të verifikojë në bashkëpunim me institucione të tjera, ose minimalisht të kërkojë/pranojë një deklaram, nëse personi përfitues, objekt i vendimit të gjykatës ka qenë i punësuar në vende të tjera. Në rast se vërtetohet se ka qenë i punësuar, të ndalë menjëherë pagesën dhe për pagesat eventuale të kryera, të bëjë përlllogaritjet dhe të kërkojë kthimin sa më parë të shumave të përfituara padrejtësisht.	Sektori i Financës Sektori Ligjor Sektori i Burimeve Njerëzore
14.	DPB të marrë masat e nevojshme, duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e shumave nga personat juridik e fizik debitorë, me qëllim që këto detyrime të realizohen si të ardhura për institucionin, para se të klasifikohen "pa shkresë arkëtimi" dhe të fshihen nga evidenca kontabile.	Sektori i Financës Sektori Ligjor
15.	Nga sektori i financës të bëhen rregullimet përkatëse të normave të amortizimit në përputhje me ligjin nr. 8438 datë 25.12.1998 "Mbi tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar për të pasqyruar saktë amortizimin e inventarit ekonomik në evidencat kontabël, duke ruajtur jetëgjatësinë normale të tyre dhe evituar zhvlerësimin e parakohshëm të inventarit në përdorim. Sektori i financës dhe buxhetit të kryejë sistemit e duhura në kontabilitet, në mënyrë që gjendja e aktiveve në pasqyrat financiare, të tregojë realisht vlerën e aktive të qëndrueshme të institucionit.	Sektori i Financës Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve
16.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të ngrejë një komision të veçantë për vlerësimin e pjesëve të këmbimit, etj, nëse ekziston mundësia që ato të përdoren dhe në pamundësi, të	Sektori i Shërbimeve Mbështetëse dhe Projekteve

	bashkëpunohet me institucionet shtetërore, për faljen/shitjen e tyre me ankand, etj	Sektori Ligjor Sektori i Financës
17.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve të marrë masa për të evituar copëzimin e fondeve gjatë procedurave të prokurimit me vlera të vogla në përputhje me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 "Mbi rregullat e prokurimit publik" të ndryshuar dhe udhëzimin nr. 2 datë 28.03.2013 "Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël", të ndryshuar, si dhe të kryejë një parashikim të mirëfilltë të fondeve në fillim të vitit.	Sektori i Prokurimeve Sektori i Financës
18.	Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës 9,785,977 duke ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe procedurat e tjera në shkallët e gjykimit.	Sektori i Financës Sektori Ligjor
19.	Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuara dhe pasqyruara në procesverbalet dhe akt verifikimet përkatës, vërejtjeve të subjektit të audituar dhe raportit përfundimtar të auditimit, Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të vendosë marrjen e masave administrative dhe disiplinore, në raport me shkeljet e kryera.	Drejtori i Përgjithshëm Sektori i Auditit Sektori i Burimeve Njerëzore